

VENDIM
Nr.34, datë 27.1.1997

PËR TATIMIN MBI BIZNESIN E VOGËL

Në mbështetje të dekretit nr.1707, datë 22.1.1997 “Për biznesin e vogël”, Këshilli i Ministrave.

VENDOSI:

1. Kuotat minimale vjetore të tatimeve të detyrueshme për t’u paguar sipas llojeve të aktiviteteve dhe rretheve do të jenë sipas pasqyrës bashkëngjitur, të cilat do të shumëzohen me koeficientët si më poshtë:

- a) Koeficienti i vendndodhjes;
- b) Koeficienti i sipërfaqes;
- c) Koeficienti i kapacitetit (për mjetet e transportit)

a) Koeficienti i vendndodhjes është:

1. Për zonën jashtë vijës së verdhë (periferia e qyteteve plus fshatrat).

1.1. Për zonën jashtë qendrës (jashtë unazës).

1.2. Për qendrën e qyteteve (brenda unazës).

b) Koeficienti i sipërfaqes është:

1. Për lokele deri me 6 m².

1.1. Për lokale mbi 6-20 m²

1.2. Për lokale mbi 20-40 m²

1.3. Për lokale mbi 40 m²

2. Kuotat në tabelë do të shumëzohen me koeficientin përkatës të pikës “a” dhe pikës “b” pavarësisht nga njëri-tjetri dhe nga produktet e tyre do të zbritet përkatësisht kuota bazë e caktuar në tabelë. Në këtë mënyrë shumatorja e shtesave sipas koeficientëve “a” dhe “b” me kuotën bazë do të jetë dyshemeja e detyrueshme për t’u paguar për llojet e aktiviteteve tëaktuara në kolonat 1, 2, 7, 8, 9, 11, 14, 15, 16 dhe 18.

Për shembull, një subjekt ushtron aktivitet tregtie me pakicë, në qendër të qytetit të Tiranës, i cili ka një sipërfaqe mbi 40 m². Kuota sipas tabelës për shembullin është 60 000 lekë x 1.2 = 72 000 lekë – kuota bazë 60 000=12 000. Kështu 12 000 lekë është shtesa sipas pikës “a”.

Shtesa sipas pikës “b” do të jetë: 60 000 x 1.2 =72 000 – 60 000 =12 000. Gjithsej dyshemeja e detyruar është: kuota 60 000 plus shtesa e parë 12 000, plus shtesën e dytë 12 000. Tatimi vjetor i detyruar për subjektin në fjalë është 84 000 lekë në vit.

3. Llojet e aktiviteteve, të përaktuara në kolonat e tjera të tabelës së bashkëlidhur vendimit, nuk do t’u nënshtrohen shtesave sipas koeficientëve të mësipërm.

4. Për shërbimin e transportit do të përdoren këta koeficientë:

a) Për transportin e udhëtarëve:

- Koeficienti 1 për mjetet deri në 5 vende;
- Koeficienti 2 për mjetet deri në 10 vende;
- Koeficienti 2.2 për mjetet deri në 25 vende;
- Koeficienti 2.5 për mjetet mbi 25 vende;

b) Për transportin e mallrave

- Koeficienti 1 për mjetet deri në 2 tonë;
- Koeficienti 1.5 për mjetet nga 2 deri në 5 tonë;
- Koeficienti 2 për mjetet nga 5 deri në 10 tonë;
- Koeficienti 2.1 mbi 10 tonë.

4. Në nënndarjen: “Tregti me pakicë” përfshihen të gjitha subjektet që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në dyqane e njësi: artikuj të ndryshëm, medikamente, ushqimore etj.

- Në nënndarjen “Tregti me shumicë” përfshihen të gjitha subjektet që ushtrojnë tregti me shumicë të çdo lloji.

- Në nënndarjen “Artizanat” përfshihen të gjitha llojet e zejeve, si bakërpunues, qilimpunues, qëndistarë, argjendari artistike, riparim këpucësh, riparim biçikletash, gomisteri, lavazh, berber,

permanent, orëndreqës, tavapjekës, rrobaqepës e të tjera të kësaj natyre.

- Në nënndarjen “Ambulantë” përfshihen tregtia ambulante riparim-shërbimi ambulant dhe çdo formë tjetër e natyrës ambulante, pra që nuk ka vendqendrim permanent.

- Në nënndarjen “Specialistë” përfshihen specialistët e fushave të ndryshme, si: ekonomistë, mjekë, inxhinierë, mësues, veterinerë, laborantë, agronomë, përkthyes etj.

- Në nënndarjen “Profesione të lira” të përfshihen: noterë, avokatë, stomatologë.

- Në nënndarjen “Prodhim i pavarur” të përfshihen të gjitha subjektet që ushtrojnë veprimtari të pavarur prodhuese për prodhim tullash, tjegullash, gëlqereje.

- Në nënndarjen “Riparim shërbime” të përfshihen subjektet që kryejnë riparime shërbime të artikujve elektroshtëpiakë e radiotelevizorë, punime dhe shërbime druri, duroalumini, tapicerie, fotografim zhvillim e stampim, si dhe agjencitë e shërbimit turistik e këmbime valutore në dyqane apo njësi të veçanta.

- Në nënndarjen “Restorante” përfshihen subjektet që ushtrojnë veprimtarinë restorant, hotele e motele.

- Në nënndarjen “Transport” përfshihen subjektet që kryejnë transportin e udhëtarëve, si dhe transportin e mallrave, kjo dhe për transportin ujor.

- Në nënndarjen “Salla lojërash” përfshihen subjektet që përdorin salla lojërash, elektronike, kënde lojërash e cirqesh, bilardo e të tjera të ngjashme me to.

- Në nënndarjen “Autoshkolla” përfshihen subjektet që organizojnë kurse për patentë makine.

- Në nënndarjen “Auto-servis” përfshihen serviset për riparimin e çdo lloj automjeti.

- Në nënndarjen “Sallone bukurie” përfshihen shërbimet e kozmetikës e zbukurimeve (tatuazhet).

- Në nënndarjen “Boutique veshje” përfshihen të gjitha dyqanet që tregtojnë veshje të cilësisë së parë, si dhe dyqanet që tregtojnë këpucë.

- Në nënndarjen “Tregti bizhuterie” përfshihen të gjitha dyqanet që tregtojnë artikuj bizhuterie, si dhe ato që tregtojnë artikuj të parfumerisë.

- Në nënndarjen “Agrobiznes familjar prodhim e tregtim” përfshihen subjektet që prodhojnë artikuj ushqimorë, si nënprodukte të mishit, brumërave e ëmbëlsirave, përpunim i kafesë, pijeve freskuese e të tjera prodhime të karakterit ushqimor.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe efektet e tij i shtrin nga 1.1.1997.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi